

Syllabus i Lëndës: Praktika Pedagogjike II

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit (Programi: MASTER I MËSIMDHËNIES NË TEKNOLOGJI DHE TIK)
Titulli i lëndës:	Praktika pedagogjike II
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	E obliguar
Viti i studimeve:	II, sem.i parë
Numri i orëve në javë:	3+0
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Kyvete S.Shatri, prof.ass.
Detajet kontaktuese:	kyvete.shatri@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Mësimi praktik përfshinë dy komponente të ndara, por të lidhura ngushtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.
Qëllimi i lëndës	<p>Gjatë praktikës pedagogjike II, studentët do të zgjerojnë njohuritë për praktikën mësimore dhe për procesin e vëzhgimit të aktiviteteve në klasë. Procesi i vëzhgimit të aktiviteteve mësimore do të fokusohet në shkollat e mesme të ulta.</p> <p>Qëllimi parësor i komponentës së mësimit praktik është që studentëve të masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathhtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë,</p>

	përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenta e mëimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Aftësimi i studentëve për punë praktike në shkollën e mesme të ultë • Vëzhgimi i realizimit të objektivave të kurrikulës bërthamë 2 • Njohja me metodologjinë e mëimit <ul style="list-style-type: none"> ○ Organizimi i klasës ○ Planifikimi i punës individuale, në çifte dhe në grupe ○ Motivimi dhe angazhimi i nxënësve ○ Ndërtimi i raporteve bashkëpunuese me të rritur dhe me nxënës • Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i vazhdueshëm • Aftësimi i studentëve për të mbajtur ditarë dhe për të reflektuar • Pjesëmarrja në mësim <ul style="list-style-type: none"> ○ Aftësimi teknik (krijimi dhe shfrytëzimi i mjeteve mësimore) ○ Asistimi i aktiviteteve në mësimdhënie ○ Këshilla dhe udhëzime nxënësve • Aftësimi për vëzhgim dhe reflektim të vazhdueshëm 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	6	18
Ushtrime teorike/laboratorike	3	5	15
Punë praktike	5	10	50
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë			

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj	1	2	2
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjerata Punë në grupe Praktikë në shkollë Reflektime ne fakultet		
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vijimi i rregullt 20 % • Portfolio 20 % • Ditari reflektiv i studentit 20 % • Vlerësimi përfundimtar 40% (Të përdoret formulari nga Doracaku i praktikës) 		
Literatura			
Literatura bazë:	A) Literatuara e obliguar: <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Edukimit. (2017) Doracaku për mësimin praktik. 2. MASHT (2011). Korniza e Kurrikulës së Kosovës 3. MASHT. Kurrikulat bërthamë (sipas natyrës së programit lëndor) 		
Literatura shtesë:	B) Literatura shtesë <ol style="list-style-type: none"> 1. Artikuj mbi shkrimin reflektiv, ditarin e studentit dhe vetëvlerësimin (te rekomanuar nga profesori i lendes) 		
Plani i detajuar i mësimi:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Përshkrimi i kursit/ Rëndësia e ndërlidhjes së teorisë me praktikën mësimore		
Java e dytë:	KKK dhe Kurrikula bërthamë- Zbatimi në praktikë Literatura: Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës (Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës)		

Java e tretë:	Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit Literatura: Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës (Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës)
Java e katërt:	Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit të mësimit Literatura: Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës (Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës)
Java e pestë:	Metodologjia e mësimit, Organizimi i klasës dhe materialet e nevojshme
Java e gjashtë:	Vlerësimi i nxënësve
Java e shtatë:	Mësim praktik në shkollë (e hene – e premtë)
Java e tetë:	Mësim praktik në shkollë (e hene- e premtë)
Java e nëntë:	Mësim praktik në shkollë (e hene – e premtë)
Java e dhjetë:	Mësim praktik në shkollë (e hene- e premtë)
Java e njëmbëdhjetë:	Reflektime mbi orët mësimore -fokusimi tek rezultatet e të nxënit
Java e dymbëdhjetë:	Reflektime mbi orët mësimore -fokusimi tek planifikimi
Java e trembëdhjetë:	Reflektime mbi orët mësimore -fokusimi tek metodat /teknikat e mësimit, organizimi i klasës dhe vlerësimi
Java e katërbëdhjetë:	Prezantimi i portfoliove -minikonferencë
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i portfoliove- minikonferencë
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p><i>-Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitet - Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohen telefonat celularë, përveq në raste kur kërkohet nga mësuesi si mjet mësimor</i></p> <p><i>- Nuk lejohet ardhja me vonë apo largimi nga ora pa arsye</i></p> <p><i>- Nuk lejohet KOPJIMI dhe cilado formë tjetër e mashtrimit gjatë provimeve</i></p> <p><i>- Studenti i vërtetohet vijimi i rregullt kur vijueshmëria është së paku 80% nga numri i përgjithshëm i orëve të planifikuara</i></p>	

